

Gjermania, shtëpia e katër milionë muslimanëve, sapo ka fituar bankën e parë Islame e cila do t'i përmbahet ligjeve të sheriatit, ndërsa ekspertët e njohur thonë se bankat islame janë më të sigurtat.

Banka turke-kuvajtiane “Kuveyt Turk” është banka e parë islame në gjermani e cila dje zyrtarisht ka filluar me punën e saj. Banka e cila ka marrë lejen nga autoritetet financiare gjermane do të ketë filialet e saja në Frankfurt, Berlin dhe Manhajm. Kjo bankë planifikon që deri në fund të vitit 2015 të hap dhjetë filiale në gjermani.

Hamed El-Merzuk, njëri nga partnerët e kësaj banke tha se janë shumë krenarë që kanë marrë lejen për hapjen e kësaj banke e cila do t'u shërbej katër milion muslimanëve në Gjeërmani.

“Kuveyt Turk” synon të stimuloj muslimanët e Gjermanisë që të shfrytëzojnë shërbimet tona. Gjithashtu do të mundohemi t'i fitojmë edhe klientët jomuslimanë që tërhiqen nga morali i biznesit islam”, deklaroi Merzuk.

Ai tha se banka nuk do të investoj në bizneset me armë. cigare. alkool dhe gjëra tjera që janë të ndaluara sipas Islamit.

Drejtori i “Kuveyt Turk” Kemal Ozan, tha se kërkesat për shërbime në këtë sektor bankarë momentalisht janë rritje.

“Të punosh në një treg konkurrues të këtillë është një sfidë e madhe”, tha ai./Islampress/